



Prishtinë, 11 nëntor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_295_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9), të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 21.6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.2004/10);
- Shkresës së KEK sh.a lidhur me marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike që prodhohet nga Hidrocentrali Radavc, KK Pejë, të lidhur mes KEK sh.a dhe Triangle General Contractors, Inc, me seli në SHBA, 1020 Cortelyou Road, Brooklyn, NY 11218, dega në Kosovë me adresë rr. "Fusha e Pejes" pa nr.,

në mbledhjen e mbajtur me datë 11 nëntor 2010, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET marrëveshja për blerje të energjisë elektrike që prodhohet nga Hidrocentrali Radavc, komuna e Pejës, të lidhur mes KEK sh.a dhe Triangle General Contractors Inc.

Arsyetim

ZRRE ka pranuar shkresën e KEK sh.a. me të cilën njoftohet për marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike që do të prodhohet nga hidrocentrali Radavc, të lidhur mes KEK sh.a dhe Triangle General Contractors Inc.

Shkresës i janë bashkangjitur Marrëveshja për blerjen e energjisë dhe Marrëveshja për dhënien me qira të hidrocentralit Radavc të lidhura mes KEK sh.a dhe Triangle General Contractors Inc si dhe Studimin e fizibilitetit për rehabilitimin dhe rivënien në punë të Hidrocentralit në fjalë.

Gjatë vlerësimit të Marrëveshjes për blerjen e energjisë (MBE) të lidhura mes KEK sh.a dhe Triangle General Contractors Inc, ZRRE ka vërejtur se ajo nuk është tërësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. ZRRE me shkresën e datës 05 gusht 2010 ka kërkuar nga KEK-u që t'i eliminojë këto mangësi ligjore të MBA-së dhe pastaj këtë ta dërgojë në ZRRE për miratim.

KEK SH.A me datë 22 tetor 2010 ka dërguar në ZRRE për miratim Marrëveshjen për blerje të energjisë me plotësimet e kërkuara nga ZRRE.

ZRRE ka vlerësuar shkresën e KEK sh.a si dhe dispozitat e marrëveshjeve të bashkangjitura, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar